

KRONIKË E ZEZË

## Prishtinë, tentohet të rrëmbehet një grua



- Dy persona u arrestuan të dielën në Gërmi, sulmuan dy policë
- Zhduket një person në Pejë
- Arrestohen dy gra në Prishtinë, dyshohen për prostitucion
- Sulmohet seksualisht në Kosovë një e mitur nga Shqipëria
- Arrestohet i mituri në Deçan, theri disa herë me thikë një tjetër të mitur
- Punëtori i postës së shpejt në Obiliq inskenon grabitjen e mbi 900 eurove, arrestohet
- Arrestohet një 66-vjeçar në Vushtrri, gjuajti me armë zjarri në aheng familjar

Policia e Kosovës ka njoftuar se një grua ka raportuar se një burrë kishte tentuar ta fuste me forcë në veturë.

Sipas raportit të Policisë, pasi kanë ardhur babai dhe vëllai i viktimës, i dyshuari me pistoletë i kishte kërcënuar ata.

Policia ka thënë se i dyshuari gjendet në arrati, ndërsa rasti është cilësuar si “rrëmbim në tentativë”.

“Rr. Çeta e Llapit, Prishtinë 08.08.2022 - 15:35. Viktima femër kosovare ka informuar se i dyshuari mashkull kosovar, ka tentuar me forcë të futë në veturë. Pasi kanë ardhur babai dhe vëllai i viktimës, i dyshuari me pistoletë i kishte kërcënuar dhe më pas ishte larguar. I dyshuari gjendet në arrati”, thuhet në raportin e Policisë.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Komento

#RREMBIM

9 gusht 2022, 08:53

Shpërndaje në



### TË TJERA



Një ton drogë kapet në ujërat e detit italian, arrestohen tre shqiptarë e dy ukrainas



Plani operativ “Motoçikleta”, shqiptohen 199 gjoba në Gjakovë



Sulmoi nënën seksualisht, arrestohet i dyshuari me probleme mendore në Pejë



Prokuroria vazhdon aksionin në Brezovicë për identifikimin e vikend-shtëpive